



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.552/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Violeta Husaj Rugova kryesuese, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja VETËVENDOSJE, me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 13.02.2025, merr këtë:

VE N D I M

HEDHET e palejuar ankesa A.nr.552/2025 e datës 10.02.2025 e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja VETËVENDOSJE!, E paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 09.02.2025.

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar ankesën: A.nr.552/2025 të datës 10.02.2025 më datë 10.02.2025, në të cilat pretendon se ka Në rezultatet preliminare të botuara në sajtin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, votat e dhëna për Lëvizjen VETËVENDOSJE! i janë regjistruar gabimisht subjektit tjetër Partia Balli Kombëtar Demokrat Shqiptar në këto vendvotime: **0104/01** ShFMU "Drita" Gramaçel, Deçani, **0402/11** ShFMU "Thimi Mitko" Gjilan, **0617/02** ShFMU "Ismail Qemali" Saradran, Istog, **1917/02** ShML "Ahmet Gashi" Prishtinë, **2010/01** ShFMU "Mati Logoreci" Prizren **2805/01** ShFIMU "Petar Kocić" Bubë, Zubin Potok. Në këto vendvotime, sipas parashtruesit të ankesës Partia Balli Kombëtar Demokrat Shqiptar ka 58, 243, 135, 159 dhe 121 vota, kurse Lëvizja VETËVENDOSJE! nuk ka asnjë votë (me përjashtim të vendvotimit 2010/01, ku ka 5 vota). Rrjedhimisht, kërkojmë nga PZAP të urdhërojë komisionet komunale zgjedhore në Gjilan, Istog, Prishtinë, Prizren dhe Zubin Potok të kontrollojnë dhe të korrigjojnë rezultatet e publikuara, në përputhje me nenin 7 i Rregullores zgjedhore nr. 13/ 2024 për rezultatet zgjedhore. Nëse ka mospërputhje

të rezultateve edhe pas verifikimit apo kontrollimit, kërkojmë nga PZAP të urdhërojë rinumërimin dhe përsëritjen e votimit sipas nenit 9.1 të Rregullores 13/2024. Parashtruesi I ankesës si provë ka bashkangjitur Pamje nga ekrani me rezultatet preleminare me 10.02.2025.

Në përgjigjen në ankesë KQZ ka theksuar se rezultatet preleminare nga vendvotimet mund të ndryshohen, korrektohen dhe plotësohen, në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) dhe Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), e Cila mundëson në evitimin e çdo gabimi teknik pas publikimit të rezultateve përfundimtare të këtyre zgjedhjeve nga KQZ-ja. Bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet e Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave të cilit do Vendvotim, ose edhe përsëritjen e votimit në një vendvotim apo Qender Votimi. Pala ankuuese, nuk e ka precizuar mjaftueshëm gjendjen faktike, nuk janë specifikuar arsyet e mospërputhjes me ndonjë dokument siç janë, vëzhguesit e akredituar, Formularët e Rezultateve të Subjekteve politike etj. Parashtruesi i ankesës po ashtu ka theksuar se ankimi i rezultatet preleminare të kësaj natyre të KQZ-së, nuk hynë në kategorinë e vendimeve të KQZ-së të cilat mund të ankimohen në PZAP.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesave, gjeti se:

Ankesat janë të palejuara

Paneli vlerëson se pretendimi i palëve ankuuese edhe pse i referohen parregullsive gjatë numërimit të votave, për shkak se përmes këtyre ankesave atakohet rezultati i cili është ende si rezultat preleminar, e i cili rezultat mund të ndryshojë, ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultatit përfundimtar i njëjti rezultat është i ankimeshëm nga subjektet politike edhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numrin e votave të tyre. Meqenëse në aspektin kohor - faza e procesit zgjedhor kur parashtrëhet ankesa është e parakohshme ankesa duhet të hedhet poshtë si e palejueshme.

Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105.1 të Ligji Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se *“PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”* dhe Neni 13.3 të Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *“PZAP-i, e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim ”*, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi për hedhjen e ankesave të palejueshme nuk e prejjudikon rezultatit përfundimtar e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore palët mund ta atakojnë rezultatit përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe 13.3 Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
A.nr. 552/2025 më datën 13.02.2025

Kryesuese e Panelit
Violeta Husaj Rugova



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.